

LIGJ
Nr. 101/2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8653, DATË 31.7.2000 “PËR NDARJEN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 108 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 2 të ligjit nr. 8653, 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, në pasqyrën numër VII të qarkut të Korçës, emri i komunës “Liqenas” dhe emërtimi i qendrës “Liqenas” zëvendësohen me emërtimet “komuna Pustec” dhe “qendra Pustec”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.3.2013

Shpallur me dekretin nr. 8072, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani